



Udhëzime për aplikues për çertifikim organik të produkteve bujqësore 2017

1. Përmbledhja e programit

Projekti “Iniciativa për Qëndrueshmëri Ekonomike Rurale” (RESI) synon promovimin e konkurrueshmërisë së fermerëve, prodhuesve bujqësor dhe të kompanive të përpunimit të ushqimit, në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës rural, krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave në komunat e synuara. Për të arritur rezultate të qëndrueshme të projektit, është e domosdoshme që të mundësohen forma të reja të prodhimit bujqësor dhe të teknologjive të reja për të rritur produktivitetin, stabilitetin, dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të prodhimit me qëllime përtej asaj të vetëm rritjes së rendimenteve, por përfshirë edhe kursimin e ujit dhe të energjisë, reduktimin e rreziqeve, përmirësimin e cilësisë së produkteve, mbrojtjen e mjedisit dhe kontributin në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Agjensioni Austriak për Zhvillim (ADA) në strategjinë e tyre për Kosovë për periudhën 2013-2020, i japin një rëndësi të veçantë përkrahjes së zhvillimit ekonomik në zonat rurale. Poashtu komuna e Prishtinës në linjë me strategjinë komunale për zhvillim, që nga viti 2015 ka rritur përpjekjet e saja për t’a përkrahur zhvillimin ekonomik në zonat rurale përmes një fokusi të veçantë në zhvillimin e bujqësisë. Agjensioni Austriak për Zhvillim (ADA) dhe komuna e Prishtinës në vjeshtën e vitit 2015 kanë nënshkruar marrëveshjen për ko-financimin e projektit për zhvillimin përfshirës dhe të qëndrueshëm ekonomik rural në komunat e synuara. Kontributi financiar i komunës së Prishtinës do të shfrytëzohet vetëm për përkrahjen e iniciativave për qëndrueshmëri ekonomike rurale në komunën e Prishtinës. Kjo thirrje për aplikim do të financohet nga kontributi financiar i komunës së Prishtinës.

2. Qëllimi i granteve

Objektivi i përgjithshëm i kësaj ftese për propozime është mundësimi i çertifikimit organik të kulturave të selektuara bujqësore në komunën e Prishtinës me potencial të lartë për plasim në tregjet ndërkombëtare dhe me ndikim në rritjen e eksportit të produkteve bujqësore.

3. Kriteret për kualifikim të aplikuesve

- Aplikuesit e pranueshëm i përkasin njëres prej kategorive të mëposhtme: fermerëve individual, shoqatave të fermerëve dhe shoqatave bujqësore;
- Aplikuesit duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës;
- Fermerët me tokë të punueshme me sipërfaqe jo më pak se 0.25 hektarë dhe maksimale prej 5 hektarë;
- Fermerët që janë kultivues të bimëve mjekësore/aromatike, specifikiisht të bimëve: Goji berry, Koprës, Kamomiles, dhe prodhuesit e mjedrës;
- Fermerët që do të startojnë në 2017, me këto bimë të lartëpërmendura mjekësore/aromatike ose janë kultivues egzistues, kultivues në vitin e parë dhe dytë të kultivimit të mjedrës në mënyrë konvencionale;

4. Kriteret shitesë për aplikuesit e përzgjedhur:

- Aplikuesit e përzgjedhur duhet të ofrojnë dokumente të pronësisë së tokës/arave (harta ose skica e tokës) të cilat planifikohen të mbillen ose janë të mbjellura, ose të ofrojnë kontrata të qirasë me periudhë minimale dhjetë vite nga data e para-përzgjedhjes për dhënien e grantit nga projekti.
- Për projektet për kalimin nga konvencionale në organike në rastin e mjedrës, aplikuesit do t'i kërkohet që të ofrojnë informacione detale mbi prodhimin aktual, fidanët e certifikuara, (shënimet mbi praktikat bujqësore të aplikuara, trajtimet e bëra për mbrojtje, trajtimin e barojave, pleherat minerale të përdorura, vjeljen e produktit, analizën fizike dhe kimike të dheut dhe ujit).
- Për projektet për vitin e parë të mbjelljes, aplikuesit do t'i kërkohet që të ofrojnë informacione mbi fidanet e certifikuara organike, analizën fizike dhe kimike të dheut dhe ujit, shënime rreth kulturave parambjelljese, burime të mundshme të ndotjes, mbajtjen e shënimeve për çdo aktivitet të përfunduar.

5. Përmasa e financimit

Sipërfaqja e tokave minimale dhe maksimale për mbjellje/të mbjellura është shpjeguar në tabelën e mëposhtme:

#	Fusha	Sipërfaqja e tokës për mbjellje
1	Çertifikimi organik për bimët mjekësore/aromatike dhe mjedrës	0.25ha- 5ha
2	Çertifikimi organik për kulturën e mjedrës në vitin e parë dhe të dytë në mënyrë konvencionale	0.5ha- 5 ha

Çertifikimi organik do të zbatohet nga një kompani e cila do të përzgjedhet nga projekti RESI dhe komuna e Prishtinës. Kontributi/pjesëmarrjes financiare e ofruar nga aplikuesi do të mirëpritet.

6. Si të aplikohet dhe afatet e dorëzimit?

6.1 Propozimi

- Aplikuesit duhet të dorëzojnë Aplikacionin '**Aneks 1 Aplikacioni teknik**', duke i'a bashkangjitur
- a) Kopje të NIF
- b) Përshkrimi i njësisë (Gjendja e tokës suaj- historia e tokës para mbjelljes së këtyre kulturave, mbajtja e shënimeve paraprake rreth fidaneve të përdorura, a janë bërë analizat të tokës dhe ujit, tokat fqinje dhe mundësia e ndotjes etj.)

Aplikuesit mund të aplikojnë në gjuhën angleze ose ato vendore, duke përdorur aplikacionin që mund të shkarkohet nga faqja e internetit të RESI-t: www.resi-ks.org. Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Raundi i financimit	Afati për dorëzimin e propozimeve	Vlerësimi
Thirrjet për propozime nga RESI/Komuna e Prishtinës, që synojnë çertifikimin organik të produkteve mjekësore/aromatike dhe mjedrës, në komunën e Prishtinës.	28 Prill 2017, ora 16:00	Finalizimi i procesit të vlerësimit nga fundi i muajit Maj të vitit 2017

Aplikacionet e pranuar pas përfundimit të afatit për dorëzim, nuk do të pranohen.

7.2 Vlerësimi i propozimeve

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet përgjatë muajit Maj 2017 dhe vetëm aplikuesit e suksesshëm do të njoftohen përmes e-mailit, më së voni brenda 1 muaji pas përfundimit të afatit të dorëzimit.

7.3 Ku dhe si ta dërgohen aplikacionet

Zarfi i jashtëm i aplikacionit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për propozime ‘**Çertifikimi organik I produkteve**’ bimë mjekësore/aromatike apo mjedër

Kërkohe nga aplikuesit të dorëzojnë një propozim origjinal në një zarf të mbyllur të formatit A4 i cili përmban brenda “Anex 1 Aplikacioni Teknik”, Kopje të NIF-it dhe Përshkrimin e njësisë.

Propozimi duhet të dorëzohet përmes postës së regjistruar ose të dorëzohet fizikisht në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Komunës së Prishtinës:

- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Prishtinës, Rr. UÇK-2-10000, Prishtinë, Kosovë.

7.4 Informacione të mëtejshme në lidhje me aplikimin

Pyetjet në lidhje me procedurat, e jo në lidhje me përmbajtjen, mund të dërgohen edhe në e-mail adresën: info@resi-ks.org, jo më vonë se 5 ditë para përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve.

7. Menaxhimi i grantit:

Pasi të përfundojë procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes, ekipi i projektit RESI do të angazhoj Kompaninë\Trupën Certifikuese për të filluar me procedurat e nevojshme për certifikim organik.